

Rritja ekonomike Tremujore

Tremujori III, 2013

Tiranë, më 8 janar 2014: Sipas treguesit të Vlerës së Shtuar Bruto (V.B.SH) ekonomia në tremujorin e tretë të vitit 2013 vlerësohet me rënie prej 2,26 % kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2012. Ndikim në këtë rënie kanë dhënë të gjitha degët kryesore të ekonomisë duke përjashtuar atë të bujqësisë.

Degët kryesore të ekonomisë për tremujorin e tretë 2013 krahasuar me tremujorin e tretë 2012 shfaqën si më poshtë:

Aktiviteti bujqësor në tremujorin e tretë të vitit 2013 krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë u rrit me 2,9 %.

Grupi i industrive u ul me 4,6 % në tremujorin e tretë të vitit 2013 krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012. Ndikimin kryesor në këtë rënie e pati industria përpunuese me rreth 7 %.

Aktiviteti i ndërtimit në tremujorin e tretë të vitit 2013 pati ulje prej 10 % krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2012.

Grupi tregti, hotele dhe restorante pati një rënie prej 3,4 % në tremujorin e tretë të vitit 2013 krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Në këtë grup, rënia me rreth 13 % e degës së hotele dhe restorante dhe degës së tregtisë me 1,6% patën ndikimin më të madh.

Aktiviteti i transportit në tremujorin e tretë të vitit 2013 u ul me 4,2 % krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Grupi i postë dhe komunikacionit u shfaq me rënie prej 1,2 % në tremujorin e tretë të vitit 2013 përkundrejt tremujorit të tretë të vitit 2012.

Grupi i shërbimeve në tremujorin e tretë të vitit 2013 pati rënie me 0,5 % kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2012. Në këtë grup, sektori financiar, administrata publike, arsimit dhe shëndetësia ndikuan pozitivisht, ndërsa rënia ndikohet nga ecuria negative e sektorit të pasurive të patundshme, rentës dhe aktiviteteve ndihmëse të biznesit (aktivitete ligjore, të arkitekturës, inxhinierike si dhe konsulenca financiare,

komerciale etj.). Gjithashtu, ndikim negativ kanë patur edhe aktivitetet e tjera të shërbimit kolektiv, social, kulturor etj.

Sa i përket ndryshimeve ndaj tremujorit pararendës, ekonomia vlerësohet me rënie prej 2 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013.

Aktiviteti bujqësor në tremujorin e tretë të vitit 2013 krahasuar me tremujorin paraardhës u rrit me 0.8 %.

Grupi i industrive pësoi rritje me 1,7 % në tremujorin e tretë të vitit 2013 krahasuar kjo me tremujorin e dytë të vitit 2013.

Aktiviteti i ndërtimit në tremujorin e tretë të vitit 2013 shënoi rënie me 20 % krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013.

Grupi tregti, hotele dhe restorante pati një rënie prej 1,2 % në tremujorin e tretë të vitit 2013 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2013.

Aktiviteti i transportit në tremujorin e tretë të vitit 2013 pësoi rritje me 0,5 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Dega e postë dhe komunikacionit u shfaq me rritje 0,4 % në tremujorin e tretë të vitit 2013 përkundrejt tremujorit të dytë të vitit 2013.

Dega e shërbimeve të tjera në tremujorin e tretë të vitit 2013 pësoi rritje me 0,5 % kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2013.

Treguesit e llogarive kombëtare janë subjekt i revizionimeve të vazhdueshme. Aktualisht sistemet e llogarive kombëtare në të gjitha vendet janë nën revizionimin e treguesve si rezultat i implementimit të sistemit të ri të llogarive europiane, ESA 2010 si dhe kasifikimit të ri për aktivitetin ekonomik, NACE Rev.2 të cilat po implementohen edhe në vendin tonë.

Në të njëjtën kohë llogaritë kombëtare në shqipëri këtë vit karakterizohen edhe nga revizionime metodologjike të cilat vijnë në kuadër të rekomandimeve të projekteve IPA 2007, IPA 2011 dhe ekspertizës të FMN. Këto revizionime do të reflektohen edhe në seritë kohore të publikuara.

Fig. 1 Ndryshimet ndaj të njëjtit tremujor të vitit 2012 për degët kryesore të ekonomisë, (t3_2013/t3_2012)





Fig. 2 Ndryshimet ndaj tremujorit të dytë të vitit 2013 për degët kryesore të ekonomisë, (t3_2013/t2_2013)



Komente

Publikimi i serieve tremujore ka si objektiv kryesor që të japë një vlerësim sa më koherent për ecurinë e ekonomisë. Këto seri përfshijnë vlerësime të V.B.SH-së tremujore me çmime konstante (ndryshimet në volum të V.B.SH-së tremujore), në të cilin nuk janë përfshirë në vlerësim taksat dhe subvencionet mbi produktet. Llogaritjet me çmime konstante janë shprehur me mesataren e çmimeve të vitit 2005. Vlerësimet për V.B.SH-në tremujore janë bërë si mbi të dhënat e pa zhveshura sezonale qoftë dhe mbi të dhënat e zhveshura nga efektet sezonale. Metoda që është përdorur për të vlerësuar V.B.SH-në tremujore konsiderohet një mënyrë indirekte.

Llogaritjet e V.B.SH-së tremujore janë konsistente me llogaritë kombëtare vjetore si dhe janë të bazuara në të njëjtat koncepte e parime. Këto vlerësime janë bazuar në të dhënat e disponueshme deri në Dhjetor të vitit 2013. Të dhënat tremujore që janë përdorur për vlerësimin e V.B.SH-së tremujore janë kryesisht të dhëna administrative si dhe të dhëna të marra nga anketat tremujore që kryhen nga INSTAT. Këto seri janë gjithmonë subjekt i revizionimeve të ardhshme, gjë e cila lidhet me përmirësimin dhe shtimin e informacionit në kohë.

Metodologjia

Të dhënat japin informacionin e parë të disponueshëm për tremujorin e tretë të vitit 2013, në lidhje me V.B.SH-në tremujore të shprehur në terma volumi të zhveshura dhe jo nga efektet sezonale. Statistikat për periudhën në të cilën po referohemi janë të bazuara në informacionin e mbledhur deri në muajin Dhjetor të vitit 2013 dhe janë subjekt i revizionimeve të mëvonshme me përmirësimin e informacionit në të ardhmen. Për vlerësimin e V.B.SH-së tremujore është përdorur një metodë indirekte. Konsiderohet si një metodë indirekte sepse të dhënat tremujore që disponohen përdoren për të gjetur vlerën e shtuar tremujore duke u bazuar në raportet që zënë këta tregues. Kjo metodë bazohet në supozimin se për periudhën në të cilin po analizojmë, raporti midis vlerës së shtuar dhe prodhimit është konstant. Në disa degë specifike si; energjia elektrike, administrata publike, arsimit, shëndetësia dhe aktivitetet financiare përdoret metoda direkte e cila bën vlerësime të prodhimit dhe konsumit ndërmjetës më vete, diferenca e të cilëve jep si rezultat vlerën e shtuar.

Vijueshmëria e llogaritjeve

Në metodën indirekte radha që ndiqet për të vlerësuar V.B.SH-në tremujore mund të jetë e ndryshme, por ajo më e përdorura vijon si më poshtë:

- i) Mbledhja dhe plotësimi i të dhënave tremujore me çmime korente dhe konstante nga burime të ndryshme të dhënash.
- ii) Krijimi i serive kohore për të dhënat tremujore në mënyrë që periudhat e ndryshme të jenë të krahasueshme mes tyre.
- iii) Kalibrimi (Benchmarking) i serive të të dhënave tremujore të pa zhveshura nga efektet sezonale me serinë e të dhënave vjetore.
- iv) Agregimi i të dhënave tremujore e më pas eliminimi i efekteve sezonale të tyre.
- v) Krahasimi i serive të të dhënave të zhveshura nga efektet e sezonalitetit.

Vlen për tu theksuar fakti që shumica e katër tremujorëve të zhveshur nga efektet e sezonalitetit jo domosdoshmërisht duhet të jetë e barabartë me vlerën vjetore të V.B.SH-së. Kjo vjen për praninë e efekteve sezonale që kanë të pranishme seritë tremujore.

Seritë e shprehura me çmime konstante me një vit bazë (2005=100)

Seritë e të dhënave janë zinxhir dhe të shprehura me çmimet e vitit 2005. Ato përshkruhen si indeksi i volumit të Laspeyres.

Seritë janë shprehur në vlerë dhe jo si indekse pasi kjo ka avantazhin për të treguar madhësitë relative të komponentëve. Përdorimi i indeksit të Laspeyres bëhet për të dhënë serive tremujore konceptet e një serie kohore, ose thënë ndryshe për të bërë periudha të ndryshme të krahasueshme mes tyre.

Kjo procedurë mund të përdoret në nivele të ndryshme agregimi, por duhet patur parasysh se vlera e shumës që vjen si rezultat i përdorimit të indeksit të Laspeyres, nuk është e barabartë me shumën që vjen si rezultat i përbërësve të saj.

Proçesi i Kalibrimit (Benchmarking)

Qëllimi kryesor i këtij procesi është që të sigurohet që llogaritë tremujore të jenë konsistente me llogaritë vjetore. Konsistenca midis këtyre dy llogarive mund të bëhet me çmime korente dhe konstante, ku si vlerat tremujore ashtu dhe ato vjetore janë të shprehura me çmime të të njëjtit vit bazë. Është për tu theksuar fakti që ky proces ruan trendin e indikatorëve tremujorë duke dhënë në këtë mënyrë ndryshimet në volum të axhustuara.

Zhveshja nga sezonaliteti

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të serive tremujore është prania e sezonalitetit në to. Ekzistojnë dy mënyra për të eliminuar efektet sezonale nga seritë tremujore.

Mënyra indirekte:

Niveli i detajimit, në të cilin një seri është zhveshur nga sezonaliteti, është e rëndësishme pasi kjo ndikon në cilësinë e serisë. Seritë individuale të degëve të ndryshme të ekonomisë mund të zhvishen nga efektet sezonale dhe më pas të agregohen në degë më të mëdha. Kjo metodë konsiderohet si metodë indirekte. Metoda indirekte ka avantazhin se i ruan më mirë efektet sezonale të një serie individuale por kjo vetëm me çmime korente sepse me çmime konstante ky efekt zbehet për shkak të ndikimit të indekseve zinxhir që krijohen.

Mënyra direkte:

Një mënyrë tjetër është që degët e ekonomisë të agregohen fillimisht në degë më të mëdha e më pas të zhvishen nga efektet sezonale. Kjo mënyrë është quajtur mënyra direkte e zhveshjes së efekteve të sezonalitetit.

Metoda direkte mund të japë rezultate më të mira nëse degët individuale të ekonomisë kanë efekte të ngjashme sezonale me njëra tjetrën. Sa më të detajuara të merren seritë e të dhënave aq më e madhe

është diferenca midis faktorëve jo të rregullt të një serie dhe atyre të zhveshur nga sezonaliteti, gjë e cila mund të humbasë objektivin kryesor që kanë efektet sezonale.

Në një vend si Shqipëria ngjarjet jo të rregullta mund të kenë një ndikim të madh në të dhëna të caktuara. Gjithsesi nëse komponentët përbërës të një serie kanë të njëjtin sezonalitet, agregimi zbut efektet e komponentëve jo të rregullta. Kjo është domethënëse për rastin e Shqipërisë ku shumë seri ekonomike ndikohen nga fluktacionet e njëjta sezonale të një dege. \

Politikat revizionuese

Një nga momentet më kryesore të serive të të dhënave tremujore janë revizionimet e tyre. Këto revizionime janë me frekuenca të ndryshme që në përgjithësi ndahen në tre grupe kryesore:

Revizionime Tremujore:

Të dhënat që bëhen të disponueshme për tremujorin e fundit kanë efekt edhe në revizionimin e tremujorëve para-ardhës, sepse: Me ardhjen e të dhënave për tremujorin e fundit vijnë edhe një sërë të dhënash të reja për tremujorët e mëparshëm, të cilat vijnë si rezultat i përmirësimeve por mund të vijnë edhe si arsye e ndryshimeve administrative. Duhet theksuar fakti që të dhënat që përdoren për vlerësimin e V.B.SH Tremujore janë kryesisht të dhëna administrative.

Futja e të dhënave të tremujorit të fundit në seri dhe më pas zhveshja e serisë së re nga efektet sezonale sjell edhe disa ndryshime për tremujorët e afërt të mëparshëm.

Revizionime Vjetore:

Duke qenë se vlerësimi i V.B.SH Tremujore mbështetet në të dhënat vjetore, ndryshimet që do të ndodhin në V.B.SH Vjetore do të reflektohen dhe në seritë tremujore. Ndryshimet vjetore vijnë si rezultat i përmirësimeve të burimeve ekzistuese vjetore ose dhe futjes së burimeve të reja. Vlerësimi i një viti kalon në tre etapa derisa arrin vlerësimin final të tij.

Ndryshimet që ndodhin në këto etapa reflektojnë edhe seritë tremujore. Efektet e ndryshimeve vjetore duke qenë se kanë një mospërputhje kohore relativisht të gjatë (vjetorja paraprake, del 11 muaj pasi viti ka përfunduar, vjetorja gjysmë finale del 17 muaj me vonesë dhe finalja 29 muaj me vonesë), japin një efekt më të madh dhe më të shtrirë në kohë në seritë tremujore.

Revizionime Metodologjike:

Përgjithësisht këto lloj revizionimesh janë si pasojë e ndryshimeve ose përmirësimeve metodologjike që ndodhin si në llogaritë kombëtare vjetore ashtu edhe në ato tremujore, që në të dy rastet do të kenë

efektet e tyre në seritë tremujore. Gjithashtu këto lloj revizionimesh mund të vijnë dhe kur burime të reja të dhënash bëhen të disponueshme të cilat do të zëvendësojnë ato të mëparshmet.